



Pranuar / Dorezuar Prenjeno / Prodato Received / Delivery	17	12	2021	1	viti god year
Organ / Njësia Org. / Unit	Nr. Prot. Pr. / No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKIMSHCK	6224/2021		1/5		



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.978/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.3137/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 16.11.2021 ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.646/2019 të datës 23.10.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga “Hasan Ramadani”, Nr.96 Komuna e Podujevës, kundër vendimit të datës 27.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet e bazuar** ankesa me numër A.nr.646/2019 e datës 23.10.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. **Shfuqizohet** Vendimi i datës 27.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës.
- III. **Obligohet** Komuna e Podujevës që t’ia bëjë kompensimin ankuesit në mënyrë retroaktive për periudhën kohore prej datës 18.07.2018 deri me datë 20.08.2019 të diferencës në pagë për dy (2) koeficient nga sa është paguar sipas koeficientit 7.5 dhe të kompensohet sipas koeficientin 9.5
- IV. **Obligohet** Kryetari i Komunës së Podujevës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2013, i punësuar në pozitën “Zyrtar i Lartë i Personelit” në Komunën e Podujevës, me vendimin nr.02-112/02-0056509/18 të Kryetarit të Komunës së Podujevës të datës 18.07.2018 është caktuar ushtrues detyre i Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Podujevës me afat të pacaktuar-deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit për pozitën e “Udhëheqësit të Personelit” në Komunën e Podujevës.

Ankuesi nga data 18.07.2019 i ka ushtruar detyrat dhe funksionet e Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Podujevës deri me datë 20.08.2019 kur edhe ka përfunduar procedura e rekrutimit për pozitën e “Udhëheqësit të Personelit” në Komunën e Podujevës.

Ankuesi në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës së Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Podujevës me datë 20.08.2019 ka parashtruar kërkesën me numër Nr.03-362 në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa me specifikacionin që t’i bëhet pagesa dhe kompensimi financiar sipas vendimit të Kryetarit të Komunës së Podujevës të datës 18.07.2019 me koeficientin 9.5.

I pa kënaqur me mungesën e përgjigjes, ankuesi me datë 17.09.2019 ka bërë kërkesë në Zyrën e Personelit të Komunës së Podujevës me kërkesën që t’i bëhet pagesa retroaktive e ndryshimit të koeficientit nga 7.5 në 9.5 për periudhën kohore nga data 18.07.2019 deri në muajin shtator të vitit 2019 për punën e kryer të Ushtruesit të Detyrës së Udhëheqësit të Personelit.

Ankuesi po ashtu me datë 17.09.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave më kërkesën që t’i bëhet pagesa sipas ndryshimit të koeficientit nga 7.5 në 9.5 për periudhën kohore nga data nga data 17.08.2019 deri në muajin shtator të vitit 2019 për punën e kryer të Ushtruesit të Detyrës së Udhëheqësit të Personelit.

Zyra e Personelit të Komunës së Podujevës me datë 19.09.2019 i ka kthyer përgjigje ankuesit me arsyetimin se Zyra e Personelit nuk është përgjegjëse për ekzekutimin e pagave.

Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës me datë 27.09.2019 ka nxjerrë Vendimi me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit të datës të datës 17.09.2019.

Ankuesi kundër Vendimit të datës 27.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.10.2019 brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4985/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 25.10.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Podujevës. Më datë 06.11.2019 Komuna e Podujevës ka dërguar përgjigjen në ankesë me dosjen e bashkangjitur të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 27.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin

për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 16.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.3137/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 27.11.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankuesit të datës 23.10.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 23.10.2019 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 4985/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 27.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës; Përgjigja e datës 19.09.2019; Vendimi me numër 02-112/02-0056509/18 i datës 18.07.2019 i Kryetarit të Komunës së Podujevës; kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 28.10.2019; Përgjigja në kërkesë e datës 06.11.2019; Shkresa e datës 17.09.2019; kopja e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesa e datës 19.09.2019 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Shkresa e datës 17.09.2019 me numër protokolli 13-104/02-0074369/19; Shkresa e datës 20.08.2019; Kërkesa e datës 20.08.2019 me numër Nr.03-362; Lista e pagave për muajin korrik të vitit 2019; Akt emërimi i datës 01.02.2013; Emaili i datës 21.11.2019 me numër protokolli:5467/2019 me shkresat e bashkangjitura: dorëheqja dhe konfirmimi; Aktgjykimit A.nr.3137/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 16.11.2021; Njoftimin e datës 27.11.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar kompetencat e tij dhe pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit
është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë analizimit të provave të ofruara nga palët në procedurë si dhe duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, ka konstatuar se sipas Akt emërimit të datës 01.02.2013 ankuesi ka qenë i emëruar në pozitën “Zyrtar i Lartë i Personelit” me koeficient 7.5, ndërsa me datë 18.07.2019 Kryetari i Komunës së Podujevës me vendimin numër Nr. 02-112/02-0056509/18 ankuesin e ka emëruar Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës dhe i njëjti këto detyra i ka ushtruar deri me datë 20.08.2019, dhe sipas listës së pagave me Kod:10-16005-615-0111 gjatë kohës sa ankuesi ka qenë Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës është paguar sipas koeficientit 7.5 konform akt emërimit të datës 01.02.2013 për pozitën “Zyrtar i Lartë i Personelit”, ndërsa në emailin e datës 21.11.2019 të dërguar Menaxherit aktual të Komunës së Podujevës me kërkesën për informata dhe prova shtesë se: “*Cili/Sa është koeficienti pagës i Menaxherit të Personelit në Komunën e Podujevës*”, Menaxheri i Komunës së Podujevës në po të njëjtën datë është përgjigjur se: “*Koeficienti i pozitës së Menaxherit të Personelit është 9.5*”.

Andaj duke u bazuar në provat e lartë cekura dhe gjendjen faktike, Kolegji ka konstatuar se ankesa dhe pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara ngase ankuesi që nga data 18.07.2019 deri me datë 20.08.2019 i ka kryer detyrat dhe funksionet e Menaxherit të Personelit të Komunës së Podujevës dhe është paguar me koeficient 7.5 në vlerën e pagës bruto prej pesëqindpesëdhjetëdypikëtridhjetë euro (552.33€), ndërsa paga me të cilën paguhet Menaxheri i Personelit në Komunën e Podujevës dhe në Komunitat e tjera është sipas koeficientit 9.5, prandaj me rastin e mos kompensimit-pagesës ankuesit sipas koeficientit 9.5 siç paguhet Menaxherët e Personelit nëpër Komuna të tjera, Komuna e Podujevës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil nëni 5

paragrafi 1 i cili përcakton se: *“Paga bazë, sipas këtij ligji është rezultat i çmimit të punës, përkatësisht vlerës për punën e thjeshtë dhe koeficientet e caktuar për çdo grup e nëngrup, si dhe shumat e rritura të përvojës së punës, për çdo vit të plotë, në përqindje të caktuar”* si dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës neni 43 paragrafi 1 i cili përcakton se: *“1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblimet, kompensimin dhe mbrojtjen ligjore, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar, politik, aftësitë e kufizuara, kushtet, statusi martesor, mosha ose prejardhja etnike”*, andaj në këtë kuptim Komuna e Podujevës është e obliguar që ankuesit t’ia bëjë kompensimin në mënyrë retroaktive për periudhën kohore prej datës 18.07.2018 deri me datë 20.08.2019 diferencën në pagë për dy (2) koeficient nga sa është paguar sipas koeficientit 7.5 dhe të kompensohet sipas koeficientin 9.5 për kohën sa ankuesi i ka ushtruar detyrat dhe funksionet e Menaxherit të Personelit sipas vendimit të Kryetarit të Komunës së Podujevës të datës 18.07.2018.

Andaj mbi këtë bazë Kolegji për shqyrtimin e ankesave e ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit të datës 23.10.2019 ngase institucioni në këtë rast Komuna e Podujevës nuk ka vepruar në mënyrë zyrtare konform dispozitave ligjore siç e obligon Ligji Nr. 03/147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Ligji Nr.06/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 27.09.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”*.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.


Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.978/2021

Elakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit*
- *Kryetarit të Komunës së Podujevës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës, dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*